




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të dt. 29.11.2020, parashtruar nga subjekti në procedurë: N.T.P. " Agoniti " me seli në Prishtinë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 lidhur me nenin 3.1 dhe 7 pika (b) të Rregullave për , më datën 02.12.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. **Hedhet poshtë si e papranueshme** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga subjektit në procedurë, **O.E : N.T.P. " Agoniti "** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **" Furnizimi me dru për ngrohje "** prok. Nr. 644 – 20 – 2120 – 1-1-1 dhe Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 022 – 111 **për shkak të mungesës së legjitimacionit aktiv të palës.**
2. **Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 26.11.2020

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të Kërkesës së Njesisë Kërkuese ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull : **Furnizimi me dru për ngrohje "**, prok. Nr. 644 – 20 – 2120 – 1-1-1 dhe Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 022 – 111.

Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues është dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. **04.08.2020**, bazuar në dispozitat e nenit 40 të LPP-së .

Në këtë Vendim të A.K. , O.E. : N.T.P. " Agoniti " në tekstin e mëtejme (Ankuesi) me seli në Prishtinë nuk ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pran A.K. , në bazë të nenit 108/A të LPP-së dh as ankesë në OSHP, në bazë të nenit 109 të LPP-së.

Mbi bazën e Kërkesës për Rishqyrtim të Vendimit të Autoritetit Kontraktues të dt. 26.11.2020 të një prej O.E. tjerë pjesëmarrës në aktivitein e prokurimit në fjalë, Organi Shqyrtues i Prokurimit,(më tej OSHP), në Vendimin e tij nr. 809/20 dt. 13.11.2020 në mes tjerash ka anuluar Njoftimin mbi Vendimin për Dhënie të Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit : **Furnizimi me dru për ngrohje**, me nr. prok. 644-20-2120-1-1-1 Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 022 – 111, ndërsa lënda është kthyer në Ri-vlerësim.

A.K., më dt. 29.12.2020, ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim të vendimit të dt. 26.11.2020, nga Ankuesi. Pasi A.K. fillimisht ka shqyrtuar afatshmërinë dhe pranueshmërinë e Kërkesës për Rishqyrtim, A.K. ka konstatuar se Kërkesa e Ankuesit është e papranueshme, sepse **palës i mungon legjitimacioni aktiv pasi që Ankuesi tani më është pajtuar me Vendimin e A.K. të dt. 04.08.2020, ndaj të cilit nuk ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, për të paraqitur ndonjë papajtueshmëri dhe / ose pretendim lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë. Rrjedhimisht, argumenti se Ankuesi nuk ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore për të shprehë pakënaqësinë – mos-pajtueshmërinë e tij lidhur me Vendimin e**

A.K. të dt. 04.08.2020, më pastaj, Ankuesin e radhitë në palë pa legjitimacion akti, andaj A.K. konsideron se nuk ka bazë për shqyrtim të mëtejme të Kërkesës së Ankuesit dhe me të drejtë, si të tillë e hedhë poshtë si të papranueshme.


Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

K.R. nr. 022/2020 - datë 02/12/2020

Aktvendimi i dërgohet:

Drejtoria për Prokurim Publik



Amir Haradinaj - Drejtor

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)